

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Nr. regj. 1226
Dt. Regj. 12.12.2019

Nr. 6403 Vendimi
Dt. Vendimi 19.12.2019

VENDIM

“Në emër të Republikës”

“Mbi kërkesën për regjistrim”

Ne Tirane, sot me date 19.12.2019 unë **Alma Kodraliu**, gjyqtare prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, pasi mora ne shqyrtim kerkesen me:

KËRKUES: Agim Seranaj, i biri i Bajram, datëlindja 13.03.1966, banues në Tiranë.

OBJEKTI: Regjistrimin e organizatës jofitimprurëse “Shoqata Shqiptare e Inxhinierisë Sizmike” (S.S.I.S) - Albanian Association of Earthquake (A.A.E.E.).

BAZA LIGJORE: Ligji Nr. 8789 dt. 07.05.2001 “Per regjistrimin e organizatave jofitimprurese”.

KONSTATOVA:

Se mbi bazën e kërkesës së cituar në pjesën hyrëse të këtij vendimi, kërkohet të regjistrohet si organizatë jofitimprurëse, “Shoqata Shqiptare e Inxhinierisë Sizmike” (S.S.I.S) - Albanian Association of Earthquake (A.A.E.E.).

Themeluesit e saj janë Agim Seranaj, Frederik Lena, Altin Piqani, Diana Lluka, Llambro Duni, Helidon Kokona, Luan Murtaç, Merita Guri, Alma Golgota, Ruben Alite, Altin Seranaj.

Selia e Shoqatës ndodhet në adresën Rr: Hysni Gërbolli, ZK 8310, kati 1, Tiranë.

Shoqata është themeluar për një afat kohor të pakufizuar.

Qëllimi i veprimtarisë së Shoqatës ka të bëjë me promovimin e zhvillimeve shkencore në fushën e inxhinierisë së tërmeteve, etj.

Organi drejtues i Shoqatës është Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve. Ndërkohë, organi ekzekutiv është Komiteti Ekzekutiv, i përbërë nga Agim Seranaj (Kryetar), Frederik Lena, Altin Piqani, Diana Lluka, Llambro Duni, Helidon Kokona, Luan Murtaj.

PËR KËTO ARËSYE:

Gjykata, në bazë të ligjit nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 8789 dt. 07.05.2001 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”;

V E N D O S I

1. Pranimin e kërkesës.
2. Regjistrimin në regjistrin e organizatave jofitimprurëse të “Shoqata Shqiptare e Inxhinierisë Sizmike” (S.S.I.S) - Albanian Association of Earthquake (A.A.E.E.). Themeluesit e saj janë Agim Seranaj, Frederik Lena, Altin Piqani, Diana Lluka, Llambro Duni, Helidon Kokona, Luan Murtaj, Merita Guri, Alma Golgota, Ruben Alite, Altin Seranaj.
Selia e Shoqatës ndodhet në adresën Rr: Hysni Gërbolli, ZK 8310, kati 1, Tiranë.
Organi drejtues i Shoqatës është Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve.
Organi ekzekutiv është Komiteti Ekzekutiv, i përbërë nga Agim Seranaj (Kryetar), Frederik Lena, Altin Piqani, Diana Lluka, Llambro Duni, Helidon Kokona, Luan Murtaj.
1. Shpenzimet gjyqesore i lihen në ngarkim kerkuesit.

U shpall në Tiranë me datë 19.12.2019

